



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data 16.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS : "Blerje asfalti",

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme: **Asfalt, çakëll dhe rërë bitumi : 14213000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Dokumentuar me relacionin e KLLFLST **nr.6041/3prot, datë 06.08.2026.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi i kriterëve të përgjithshme: Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit janë ato të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, në përputhje me nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nuk ndryshohen nga Autoriteti Kontraktor. Përmbushja e tyre deklarohet nga operatorët ekonomikë nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së. Për këtë arsye, kriteret e përgjithshme zbatohen sipas formularëve standardë dhe nuk argumentohen individualisht nga Autoriteti Kontraktor në këtë procesverbal.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në nenin 83, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 30, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Këto kërkesa sigurojnë deklarimin paraprak të përmbushjes së kushteve të kualifikimit dhe seriozitetin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.

- Sipas Ekstraktit të QKB-së në veprimtarinë e operatorit ekonomik duhet të ketë të përfshir objektin e kësaj procedure prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron ligjërisht veprimtarinë profesionale dhe se fusha e veprimtarisë së regjistruar në QKB përfshin objektin e kësaj procedure prokurimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, përkatësisht 932 800 lekë pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 43 dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë fondin limit prej 1 250 000 lekë pa TVSH, vlera e kërkuar e xhiros është përcaktuar në masën 40% të fondit limit, përkatësisht 500 000 lekë. Ky nivel është

proporcional me vlerën e kontratës dhe synon të vërtetojë se operatori ekonomik ka kapacitet të mjaftueshëm ekonomik dhe financiar për realizimin me sukses të saj.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 si dhe **këstet e maturuara të vitit 2026**, (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2026.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme lidhet me përmbushjen e detyrimeve fiskale të operatorit ekonomik dhe bazohet në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kriteri synon të vërtetojë se operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet e taksave dhe tarifave vendore sipas afateve të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 466 400 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ***të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ***plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 55, pika 4, shkronja “b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është përcaktuar në masën 20% të fondit limit, përkatësisht 250 000 lekë. Kjo kërkesë është proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe shërben për të vërtetuar se operatori ekonomik ka përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të furnizimit objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë ku shprehet se do të realizojë dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të vendosura në Shtojcën 6 – Formulari i Specifikimeve Teknike, si dhe brenda afatit të përcaktuar në Shtojcën 7 të DST-së.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset nga Autoriteti Kontraktor si garanci që furnizimi dhe dorëzimi i mallrave do të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2.3.3 ISO 9001:2015 - Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) në përputhje me objektin e prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj çertifikatë ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO

Argumentimi: Kërkesa e cilësisë të përcaktuara sipas pikës **2.3.3** është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë të mallve me çmime të ulta.

Pajisja me këtë certifikatë ISO garanton se operatori ekonomik zbaton një sistem menaxhimi të cilësisë, me qëllim sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe në përputhje me kërkesat e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi **1 (një) shofer 1 (një) manovrator**, të nevojshëm për procesin e shkarkimit dhe shpërndarjes së materialeve objekt prokurimi në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Punonjësit duhet të jenë të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Për punonjësit, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- dokumentacionin që vërteton se punonjësit figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5, shkronja “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për 2 (dy) punëtorë të thjeshtë lidhet me nevojën për shkarkimin dhe shpërndarjen e materialeve objekt prokurimi në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Numri i kërkuar është minimal dhe proporcional me natyrën e furnizimit dhe synon realizimin në kohë e pa ndërprerje të kontratës.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik duhet të paraqes/in deklaratë që furnizimi i mallrave do të realizohet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues, brenda afatit të përcaktuar nga Bashkia Roskovec.

Dëshmi për mjetet që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8), konkretisht:

Nr.	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qira

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b. Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet:

a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi; b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); c) leje qarkullimi; ç) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c. Për mjetet që, sipas përcaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor, nevojitet targë, leje qarkullimi etj., operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubrikat përkatëse, të dhënat për secilin mjet të kërkuar në Shtojcën 8.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për 2 (dy) kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton është vendosur për të garantuar kapacitetin e nevojshëm të transportit për realizimin e furnizimit. Kërkesa merr në konsideratë sasinë e materialeve, shpërndarjen e tyre në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë Roskovec dhe afatin e lëvrimit, duke lejuar disponimin e mjeteve si në pronësi ashtu edhe me qira.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga KLLFLST dhe shprehin qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor lidhur me cilësinë dhe mënyrën e kryerjes së punimeve, sipas materialit bashkëlidhur në SPE.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me materialet elektrike, duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për materialet elektrike janë vendosur parametra teknike sipas nevojave funksionale të Bashkisë Berat dhe Njësi Administrative duke përdorur një minimum dhe maksimum të parametrave me qëllim për të mos kufizuar konkurrencën si dhe për të patur një pjesëmarrje të lartë të operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.88, datë.08.09.2026**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: "Blerje çakull, stabilizante dhe rërë bituminoze", me fond limit prej: **1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë)** lekë pa tvsh, lloji i procedurës: E hapur e thjeshtuar

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP, I ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE: BASHKËLIDHUR DST NË SPE

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Anëtarët pranuan preventivin e hartuar nga Komisioni i posacëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.6013 prot,datë 06.08.2026,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë. *Për sa i përket specifikimeve teknike komisioni për hartimin tyre dhe të preventivit me cmime, referencat i ka çmimet i ka bazuar te studimi i tregut,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.6041/3 prot,datë 06.08.2026 procesverbali dhe preventivi janë hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST ,dorëzuar specifikimet dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. nr.6041/2prot,datë 06.08.2026 dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.*

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	F.V (Funizim Vendorsje) Asfalt	M3	50

Fillon nga data e lidhjes së kontratës dhe mbaron deri më 1 (njtë) vit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor .

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit,pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t’u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: